


Termet e Referencës për Shërbimin e Sigurisë për Qendrën Piramida

Ofrimi i Shërbimeve të Sigurisë dhe Mirëmbajtjes së Sistemeve Mbështetëse të Sigurisë për Qendrën Piramida



PIRAMIDA

TUMO **TIFANA**

Kohëzgjatja: Dy vjet me mundësi rinovimi për një vit tjetër

Data e fillimit: 1 ___ 2024

Data e Mbarimit: 31 ___ 2026

HYRJA DHE HISTORIKU

Një projekt partneriteti midis AADF dhe Bashkisë së Tiranës është ndërtuar si një përpjekje ambicioze për të shndërruar monumentin komunist në zemër të kryeqytetit në një qendër edukimi teknologjik multifunksional për të rinjtë.

Piramida e Tiranës është më shumë se një qendër teknologjike, qëllimi ynë është të krijojmë një mjedis që inkurajon inovacionin dhe kreativitetin duke ofruar akses në një mjedis modern, në facilitete dhe pajisje të teknologjisë së fundit. Piramida e Tiranës do të presë shumë biznese dhe institucione të ndryshme, si Kolegji i Evropës, si dhe në qendër të saj do të jetë TUMO Tirana.

Kjo kërkon ofrimin e Shërbimit të Sigurisë dhe shërbimet mbështetëse gjatë dy viteve për të gjithë objektin, zyrat dhe ambientet e përbashkëta. Për këtë arsye, Qendra Piramida po planifikon të lidhë një marrëveshje afatgjatë, me një kompani profesionale dhe të kualifikuar për të ofruar shërbime të tilla fillimisht të vlefshme për dy vjet me mundësi rinovimi edhe për dy vjet shtesë në bazë të performancës dhe nevojës. Nepërmjet këtij shërbimi pritet të realizohet sigurimi i zonave të përbashkëta të të gjithë ndërtesës Piramida duke përfshirë por pa u kufizuar në sa më poshtë: hapësirat e përbashkëta brenda ndërtesës (korridoret), zyrat, zonat teknike të ndërtesës (dhomat e magazinimit, zyra e sigurisë, dhoma e serverit etj. Si dhe mirëmbajtja e sistemeve të sigurisë mbështetëse që do të përfshijë instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kamerave CCTV, sistemit të alarmit, sistemit të bllokimit të hyrjes me pistonë dhe sensorëve brenda zyrave dhe zonave të përbashkëta.

TUMO Tirana

Siç u përmend, në zemër të Piramidës do të jetë TUMO Tirana, i cili në thelb është një program pasqullor që ofron kurse edukative për studentët e tij në fushën e teknologjive krijuese. Vlen të theksohet se studentët në TUMO Tirana janë të mitur, kështu që duhet treguar kujdes të veçantë që të gjitha masat e sigurisë të krijojnë një mjedis të sigurt për mbrojtjen e fëmijëve.

Të gjitha masat e sigurisë brenda kateve të dedikuara TUMO Tirana, veçanërisht katet +1 dhe +2, luajnë një rol jetik në ruajtjen e ambienteve dhe garantimin e sigurisë së përdoruesve të tij. Bashkëpunimi i pandërprerë midis Qendrës Piramida dhe TUMO Tirana dhe personelit të tyre të përbashkët të sigurisë kërkon një angazhim për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe harmonik për të gjithë stafin, vizitorët dhe pjesëmarrësit, duke promovuar një ndjenjë sigurie dhe besimi në të gjithë objektin.

FUSHA E SHËRBIMIT QË DUHET TË OFROHET

Propozimet kërkohen nga kompani të licencuara dhe me reputacion që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh sigurie me të paktën pesë vjet përvojë paraprake në mbikëqyrjen e objekteve të rëndësisë të veçantë dhe trajtimin e situatave të ndryshme emergjente që përfshin ekspertizë të konsiderueshme të menaxhimit në dhomat e kontrollit. Kjo përfshin jo vetëm monitorimin e sistemit CCTV, por edhe menaxhimin e sistemit audio, menaxhimin e zjarrit dhe koordinimin e pikave të evakuimit.

Shtrirja e shërbimeve të kërkuara përfshin, por nuk kufizohet në:

- Shërbimet e sigurisë dhe mirëmbajtja e sistemit mbështetës të sigurisë
- Shërbim sigurie me personel brenda ambienteve të brendshme të godinës Piramida.

- Shërbim sigurie me personel jashtë, brenda kufijve të perimetrit të jashtëm të Qendrës Piramida.
- Mbikëqyrje 24 orëshe e Qendrës së Kontrollit me Kamera me operator. Qendra është krijuar tashmë brenda piramidës.
- Instalimi dhe mirëmbajtja e kamerave CCTV shtesë me rezolucion të lartë dhe pajisje shtesë të dhomës së mbikëqyrjes.(Kërkesat minimale të dhëna në Aneksin 1)
- Instalimi dhe mirëmbajtja e barrierave të automatizuara me pistonë në 2 (dy) hyrje të Qendrës Piramida. (Planet dhe kërkesat minimale të dhëna në Aneksin 1). Kompanisë i kërkohet të sigurojë lejet e nevojshme për instalimin e barrierave të automatizuara.
- Instalimi i sistemit të alarmit dhe paralajmërimit të cilësisë së lartë . (Kërkesat minimale të dhëna në Aneksin 1)

DORËZIMET PRITSHME PËR PËRMBUSHJEN E FUSHËS SË PUNËS

Kontraktori pritët të performojë në një nivel ekselence duke ofruar shërbimet e mëposhtme:

- Shërbimi i sigurisë së Qendrës Piramida dhe ambjenteve rreth saj nëpërmjet personelit dhe mjeteve të teknologjisë
- Instalimi, mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e sistemeve teknologjike të përshkruara në këtë dokument
- Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kamerave CCTV
- Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të alarmit dhe paralajmërimit
- Vëzhgim i pandërprerë i imazheve të ofruara nga teknologjia në dhomën e mbikëqyrjes
- Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të kontrollit të trafikut (pistonave të trafikut) për dy hyrje
- Raportimi periodik në Qendrën Piramida
- Respektimi i orarit të shërbimeve të sigurisë
- Përgjigje dhe reagim i menjëhershëm ndaj vëzhgimeve dhe kërkesave përkatëse të Qendrës Piramida
- Respektimi i standardeve të cilësisë së shërbimit sipas kërkesave të kontratës dhe ligjit

PËRSHKRIMI I DETAJUAR I SHËRBIMIT

Kompania pritët të sigurojë të gjithë punonjësit dhe çdo shërbim ose furnizim tjetër të nevojshëm për të ofruar shërbimin e kontraktuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: uniformat, pajisjet dhe sistemet e paralajmërimit, në përputhje me kërkesat, afatin kohor dhe me çmimin e rënë dakord në kontrata.

PERSONELI I ANGAZHUAR

Misioni kryesor i shërbimit të rojeve është të sigurojë mbrojtje për asetet, vizitorët dhe personelin e Qendrës Piramida, nga dëmtimi ose humbja për shkak të një akti keqdashës ose shkeljes së rregullores operacionale. Rojet veprojnë si një skaner i jashtëm i sistemit të mbrojtjes dhe paralajmërimit të hershëm.

Kompania pritët të ofrojë roje të kualifikuar, me shëndet të mirë fizik, të aftë për të mbrojtur të tjerët dhe veten e tyre dhe të njohur me ligjin dhe kërkesat e kontratës në lidhje me shërbimin dhe përgjegjësitë.

Personeli kryesor i propozuar për këtë kontratë duhet të ketë diplomat dhe certifikatat e duhura dhe të ketë të paktën 10 vjet përvojë në detyrën e caktuar.

Kompania do të caktojë një personel sigurie që të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e rojeve, të dedikuar për llogarinë Piramida Center dhe të disponueshëm sipas orarit të punës të mësipërm.

Kompania do të sigurojë të gjithë personelin, mbikëqyrjen dhe materialet dhe pajisjet e nevojshme për të kryer punën siç kërkohet nga Piramida Center dhe të përcaktuara këtu.

Kompania do të ofrojë të gjitha uniformat dhe veshjet/mbulesat sezonale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: doreza, syze sigurie, maska për fytyrën, këpucë dhe mbulesa koke për të përmbushur kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Në datën e fillimit të kontratës, Kompania do të nis një Program sigurie, duke përfshirë një plan trajnimi për sigurinë për punonjësit që kryejnë punë sipas kësaj kontrate. Plani duhet të përfshijë një trajnim për njohjen e objektit për të gjithë punonjësit menjëherë pas punësimit të tyre dhe të paktën çdo gjashtë muaj .

Kompania është përgjegjëse për sigurimin në punë të punonjësve të saj. Punonjësit e kompanisë nuk konsiderohen në asnjë moment punonjës të Qendrës Piramida.

Për këtë kontratë, kompania duhet të angazhojë stafin e mëposhtëm:

Të paktën një Inxhinier Elektronik

- Diplomë universitare në inxhinieri elektronike
- 10 ose më shumë vite përvojë kumulative në projektimin e sistemeve elektronike

Të paktën një Specialist i Sigurisë TIK

- Diplomë universitare në IT, siguri kibernetike ose të ngjashme
- 10 ose më shumë vite përvojë kumulative në IT

Të paktën tre teknikë elektronike

- Një zyrë operative lokale me ekip shërbimi të dërgimit të drejtpërdrejtë 24/7 me një kohë përgjigjeje maksimumi 15 minuta

Të paktën 17 roje sigurie të mirë trajnuar dhe në formë fizike optimale

Personeli i sigurisë do të organizohet në turne që zgjasin maksimumi 8 orë secila për të garantuar sigurinë dhe funksionimin e vazhdueshëm të objektit për 24 orë. Një fuqi punëtore totale e kombinuar prej 17 punonjësish, të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë operatorët e Qendrës së Kontrollit, do të shpërndahet në tre turne:

1. Turni i parë (07:00-15:00) - Tre punonjës të shërbimit të brendshëm me një operator të Qendrës së Kontrollit dhe dy punonjës patrullimi.

2. Turni i dytë (15:00-23:00) - Tre punonjës të shërbimit të brendshëm me një operator të Qendrës së Kontrollit dhe dy punonjës patrullimi.

3. Turni i tretë (23:00-07:00) - Dy punonjës i shërbimit të brendshëm me një operator të Qendrës së Kontrollit dhe dy punonjës patrullimi.

Mbikëqyrësi i rojes do të ndihmojë në koordinimin e patrullave dhe detyrave të brendshme.

PAJISJET DHE FURNIZIMET

Kompania kërkohet të sigurojë:

- Pajisje dhe furnizime të specializuara (p.sh., spray piper, pranga, sistemi paralajmërues, pajisje shtesë mbikqyrjeje nëse është e nevojshme),
- Plani i detajuar i furnizimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së sistemi shtesë CCTV (kamera, NVR, HDD) dhe specifikimi teknik i llojeve të pajisjeve. (Kërkesat minimale sipas specifikimeve teknike që janë dhënë në Aneksin 1)
- Plani i detajuar i furnizimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së barrierave të automatizuara të shtyllave në dy hyrje të Qendrës Piramida dhe specifikimi teknik i llojeve të pajisjeve. (Planet, fotot dhe kërkesat minimale janë dhënë në Aneksin 1)
- Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të alarmit dhe paralajmërimit sipas kërkesave minimale të parashikuara në Aneksin 1
- Uniforma standarde që shfaqin dukshëm emrin e Kompanisë. të përshtatshme për detyrat e tyre specifike, subjekt i miratimit paraprak nga Menaxhmenti i Qendrës Piramida

SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË NDAJ PALËVE TË TRETË:

Në zbatimin e kësaj kontrate, përgjegjësia e përgjithshme bie mbi kontraktorin. Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për çdo dëmtim të pasurisë ose lëndim trupor, duke përfshirë vdekjen, në pronësi ose të pësuar nga ndonjë palë e tretë.


Kontraktuesi do të marrë sigurimin e përgjegjësisë dhe performancës ndaj palës së tretë me një kompani sigurimesh me reputacion. Kufiri minimal i dëmshpërblimit do të jetë 1,000,000 € për ndodhi ose në total.

ÇMIMI I KONTRATËS

Çmimet për shërbimet dhe furnizimet bazë mujore do të jenë fikse gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Qendra Piramida ka të drejtë të kërkojë ndryshime në numrin e personelit të dedikuar, furnizimet ose vëllimin e shërbimeve të kërkuara në varësi të nevojave të saj.

ANNEX 1



● **KËRKESAT MINIMAL PER SISTEMIN E BARRIERAVE TË AUTOMATIZUARA ME PISTONA**

Një numër minimal prej 4 (katër) pistonash të lëvizshëm me specifikimet e mëposhtme:

Dimensionet (mm)

Diametër	275
Lartësi	700
Trashësi	4

Piston i lëvizshëm, i operuar nga një sistemi i pajisur me çelës komandues. I përshtatshëm për përdorim në zonat rezidenciale, industriale dhe qendrat e qyteteve. Lartësia nga toka është 700 mm. Cilindri prej çeliku, 4 mm trashësi dhe \varnothing 275 mm dhe i veshur me pluhur poliestër. Kokë cilindri prej alumini me buzë gome. Rezistenca ndaj thyerjes 240.000 J.

Një numër minimal prej 4 (katër) pistonash të palëvizshëm me specifikimet e mëposhtme:

Dimensionet (mm)

Diametër	275
Lartësi	700
Trashësi	12

PERDORIMET DHE SIGURIA

Projektuar për të kontrolluar trafikun e automjeteve dhe aksesin në rrugë, sheshe, qendra historike, korsi, zona të kufizuara trafiku, zona për këmbësorësh ose zona parkimi. Ndikim minimal arkitektonik, urban dhe mjedisor.

Vaj-hidraulike

Njësia lëvizëse dhe aktivizuesi të integruar brenda strukturës së shtyllës dhe cilindrit. Valvula solenoid për ulje brenda një kohe prej 5 s në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

I forte

Dimensionet: \varnothing 275 x 700 mm (nga niveli i tokës). E përbërë prej çeliku me finiturë të lyer me pluhur poliester, drita LED të inkorporuara, rezistente ndaj rrëshqitjes, rezistente ndaj shkeljes dhe kokë alumini me buzë gome.

Siguria e certifikuar

Gama e plotë e aksesorëve për të arritur një instalim të certifikuar: detektor me unazë për masa metalike, semaforë, shenja paralajmëruese, komandim emergjent dhe automatik duke thyer xhamin, E.A.R. 35 pajisje akustike që zbulon sirenat e automjeteve për sigurinë publike dhe urgjencat dhe lejon uljen e menjëhershme të pistonit. Lëvizja sinjalizuese Beeper.

Sistemi i kontrollit

Njësia e kontrollit elektronik duhet të vendoset në mënyrë të tillë që mund të menaxhojë disa pistonat në të njëjtën kohë.

● KËRKESAT MINIMINALE PËR SISTEMIN E ALARMIT DHE PARALAJMËRIMIT

Sistemi duhet të jetë me valë dhe duhet të përbëhet nga të paktën 8 lëshues zëri dhe 60 detektorë lëvizjeje me kërkesat si më poshtë:

Sistemi kryesor

Përballon 100 hyrje-dalje wireless
Përballon 8 sirena wireless
Përballon 4 përsëritës wireless
Përballon 32 zona
Regjistër me 5,000 evente
Frekuenca RF
Modul IP
Modul Wi-Fi
Modul GPRS/3/4G
Përballon IPC dhe PIRCAM
I projektuar me Dual SIM card
SMS alarmi për çdo event
Thirrje me alarm zanor përdoruesi fundor

Lëshuesit e zërit të jashtëm (Sirenat)

Transmetim deri në 1,600 m distance
Fuqi zëri e sirenës deri në 110 dB

Detektorët e Lëvizjes Wireless Dual-Tech

Teknologji IFT
Kompensimi dixhital i temperaturës
Distancë transmetimi deri në 1,600 m
Rreze zbulimi 12 m, 90°
Imunitet nga kafshët deri në 30 kg
Technologji PIR + mikrovalë
Monitim në murë

● KËRKESAT MINIMINALE PËR SISTEMIN E KAMERAVE CCTV

Më poshtë janë skedat teknike të gjitha pajisjeve që janë instaluar tashmë në Piramidë. Këto duhet të shërbejnë si kërkesa minimale si dhe cdo pajisje tjetër duhet të përshtatet me to në mënyrë që të shërbejë si një sistem i tërë.